

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Data 14.03.2023**

**Ora 16:08**

***RENDI I DITËS***

**“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Demokratike” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,  
Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:**      **PD, LZHK, PDIU**
- **Të tjerë:**      **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Fillojmë. Në seancën e sotme në rendin e ditës kemi tri çështje: vazhdimin e shqyrtimit administrativ për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, po kështu vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës së Partisë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar për t’u regjistruar edhe ajo si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 dhe çështja rishtas kemi shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Komitetit Nismëtar, që do të organizojë punën për paraqitjen e kandidatit të mbështetur nga zgjedhësit për zgjedhjet e 14 majit 2023 për Bashkinë e Tiranës, zotin Arlind Qori.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*


Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me vazhdimin e shqyrtimit administrativ për kërkesën e paraqitur nga partia politike Partia Demokratike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e 14 majit 2023. Në seancën e shkuar vendosëm që t'i japim kërkuarit 48 orë kohë për të plotësuar dokumentacionin, i cili në vlerësimin tonë nuk ishte i plotë ose i saktë. Jemi këtu sot edhe pasi Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve rrëzoi kërkesën e ankuesve për këtë vendim të ndërmjetëm të marrë nga Komisioneri, kështu që fjala është për palët pjesëmarrëse në këtë proces administrativ. Pikë së pari, nëse keni ndonjë deklaram në lidhje me plotësimin e asaj çfarë u kërkua në vendimin e ndërmjetëm të Komisionerit. Po, zoti Sefa, fjala është për ju.

**Z. I. Sefa:** Së pari, ka të bëjë me një kërkesë procedurale, rastësisht duke u ulur këtu, u ndesha me një projektvendim "Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar" për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023". Kërkoj projektvendimin për Partinë Demokratike.

**Z. I. Celibashi:** Në pamje të parë duket sikur jeni duke bërë një kërkesë që është me legjitimitet, por nuk ka asnjë legjitimitet kjo kërkesë. Ai është një projektvendim, është një copë letër, që nuk ka asnjë lloj vlere dhe domethënie.

**Z. I. Sefa:** Të njëjtën copë letre duam edhe për Partinë Demokratike, projektvendim nga Komisioneri që të dimë mendimin e Komisionerit, të mbajmë edhe qëndrimin mbi mendimin e Komisionerit. Siç është rregull, siç e do edhe zakoni në KQZ, përpara se të diskutohet në seancë publike, dërgohet projektvendimi që palët të kenë mundësi të njihen e të mbajnë qëndrime për vendimmarrjen e Komisionerit.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Zoti Sefa, ai është një projektvendim i propozuar nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sipas atij propozimi do të vendosë Komisioneri bazuar edhe në dëgjesat e palëve. Është një projektvendim për rastin për Lëvizjen për Zhvillim Kombëtar, administrata ka bërë një rekomandim. Për rastin e Partisë Demokratike nuk e ka gjetur të mundur për të bërë një propozim të tillë. Jo, nuk ka. Ai është një projektvendim. Në fund të fundit, ne do t'ju dëgjojmë dhe do të vendosim.

**Z. I. Sefa:** Zakonisht dëgjohe mi pasi kemi opinionin e Komisionerit në lidhje me atë çështje.

**Z. I. Celibashi:** Asnjëherë nuk është vendimi opinion i Komisionerit. Komisioneri nuk ka opinion, jep vendimin pas shqyrtimit të projektvendimit. Projektvendimet i paraqet administrata. Për rastin tuaj nuk ka paraqitur një projektvendim për vetë natyrën e çështjes, është normale, nuk ka ndonjë gjë anormale në këtë mes.

**Z. I. Sefa:** Vetëm në këtë rast nuk paska. Së dyti, përsëri kërkesë procedurale. Komisioner, juve ju kanë ardhur dy kërkesa të ndryshme. Me sa u njohëm nga vendimi nr. 158, ora 10.00, i jeni referuar në mënyrë të gabuar kërkesës Indrit Sefa në cilësinë e përfaqësuesit të zotit Lulzim Basha si kryetar i Partisë Demokratike. Unë jam përfaqësues i Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe kërkesës është Partia Demokratike e Shqipërisë. Kjo gjë kërkoj të rregullohet në mënyrë imediate. Gjithashtu, janë dy kërkesa të ndryshme që Komisioneri do t'i vlerësojë në vendime të veçanta dhe në asnjë rast në një vendim të përbashkët, sepse fati i secilës prej këtyre kërkesave nuk mund të ndikojë në efektet ligjore dhe të afateve të Kodit

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

Zgjedhor mbi subjektin tjetër. Ndaj, zoti Komisioner kërkoj që në shqyrtimin tuaj të merren kërkesat në mënyrë të veçantë, sepse janë dy kërkesa të veçanta, me dy subjekte të ndryshme dhe, siç keni paraqitur dokumentacionin, është në vlerësimin tuaj të merrni çfarëdolloj vendimmarrje, por kërkesa duhet të jetë e veçantë dhe shqyrtimi duhet të bëhet në mënyrë të veçantë. Kjo për sa i përket anës procedurale që besoj se Komisioneri do të reflektojë. E treta, kërkoj që të disponohen në dosje edhe shkresat nr.1602 Prot, datë 11.3.2023, në protokollin tuaj, të depozituar nga Partia Demokratike, si dhe shkresa me nr. 1650 Prot, datë 14.3.2023, të cilat janë depozituar sot. Kërkoj të bëhen pjesë e dosjes dhe të jenë në shqyrtim nga ana e Komisionerit përpara vendimmarrjes. Këto janë kërkesa procedurale, pastaj të fillojmë me shqyrtimin në themel të kërkesës.

**Z. I. Celibashi:** Lidhur me dokumentacionin, çdo dokumentacion që është paraqitur këtu do të jetë pjesë e dosjes që lidhet me këtë shqyrtim administrativ. Lidhur me kërkesën tjetër procedurale, sikurse ju e përkufizuat, po, është e vërtetë, ne shqyrtojmë kërkesën e Partisë Demokratike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor kjo është e vërtetë dhe vendimmarrja do të jetë mbi kërkesën e Partisë Demokratike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor. Jeni ju që po thoni ka dy kërkesa, një kërkesë ka. Tani unë nuk e di se cilën kërkesë do të ndaj, unë këtë kërkesë jam duke shqyrtuar.

**Z. I. Sefa:** Komisioner, kërkesa është drejtuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë.

**Z. I. Celibashi:** Atë kërkesë po shqyrtojmë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Z. I. Sefa:** Por në këtë vendim ka dy kërkues. Në rast se ju legjitimoni kërkues të tjerë në emër të subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë, është problematika juaj, por në vendimin tuaj nr. 158 janë dy kërkues. Besoj se jam mjaftueshëm i qartë për t'u relatuar që kërkues është vetëm një dhe është Partia Demokratike e Shqipërisë. Në qoftë se ka kërkues të tjerë, që pretendojnë që përfaqësojnë Partinë Demokratike, është kompetenca juaj në bazë të ligjit të vlerësoni ligjshmërinë e asaj kërkese, por në kërkesën e depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë të firmosur nga unë si përfaqësues i saj duhet të jetë vetëm një kërkues në atë vendimmarrje.

**Z. I. Celibashi:** Unë më duket sikur po e them qartë, ka vetëm një kërkues, kërkues është Partia Demokratike e Shqipërisë. Legjitimiteti i atij që e bën këtë kërkesë është çështje e shqyrtimit. Këtë po bëjmë.

**Z. I. Sefa:** Janë dy kërkesa të protokolluara veçmas, që i keni bashkuar në një.


**Z. I. Celibashi:** Unë po shqyrtoj sot kërkesën e Partisë Demokratike. Nuk di si mund ta them ndryshe. Unë po shqyrtoj kërkesën e Partisë Demokratike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor. Keni gjë tjetër për të thënë?

**Z. I. Sefa:** Në lidhje me themelin?

**Z. I. Celibashi:** Po, në lidhje me themelin.

**Z. I. Sefa:** Dakord. Zoti Komisioner, së pari, kam disa pyetje për ju që lidhen me faktin se çfarë masash ka marrë Komisioneri në respektim të nenit 64, shkronja "e", të Kodit Zgjedhor për të bërë kallëzim penal ndaj kryetarëve të partive, të cilat pasi

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

kanë firmosur këtë deklaratën, strukturat e tyre drejtuese, kandidatët e tyre në listat e zgjedhësve janë dënuar me vendim penal të formës së prerë për shitblerje votash.

**Z. I. Celibashi:** Vetëm në respektin tuaj dhe mënyrës sesi ne i ndërtojmë raportet me përfaqësuesit e partive politike po ju përgjigjem pasi pyetja nuk ka lidhje fare me çështjen objekt shqyrtimi. Përgjigjja është kjo: kjo është një çështje e cila vlerësohet rast pas rasti nga ana e Komisionerit apo edhe më tej nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por sikurse e thashë nuk ka lidhje me çështjen që po shqyrtojmë. Është në të drejtën tuaj ta përdorni qoftë përgjigjen, por edhe arsyen e pyetjes suaj si argument në pretendimet që ju do të mbani.

**Z. I. Sefa:** Zoti Komisioner, ngaqë ju e keni trajtuar këtë formulim që është në këtë deklaratë solemne si një impenjim personal i individit, ndërkohë që Kodi dhe vendimi i Komisionit Rregullator pranë KQZ-së shprehet qartë që është impenjim i marrë si pasojë e funksionit që ka individit si kryetar partie dhe angazhohet solemnisht që partia nuk do të marrë pjesë në aktivite për shitblerjen e votës e të gjitha me radhë siç përcaktohet edhe në formulën e kësaj deklarate. Gjithsesi, ky është opinionimi kundër që ne kemi me njëri-tjetrin edhe në interpretim të dispozitës. Ne jemi të bindur, Komisioner, që ajo është një detyrim që vjen si pasojë e funksionit që ka dhe si i tillë ai mund të delegohet, siç mund të delegohen edhe të drejtat që përfitohen si pasojë e funksionit të individit. Ndaj, Komisioner, interpretimi juaj nuk lidhet me zbatueshmërinë e ligjit dhe si rrjedhojë kjo vendimmarrje dhe zgjatje e këtyre afateve i ka sjellë një dëm të jashtëzakonshëm Partisë Demokratike, sepse praktikisht ne sot jemi në limitet e bërjes së kërkesës për koalicione partiake zgjedhore. Siç jeni në dijeni, afati i fundit është data 15 dhe në një rast të vendimmarrjes suaj që, siç kuptohet nga ana juaj, është e njëjtë me atë ç'ka keni


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

shprehur. Kjo ka cenuar rëndë procesin, duke ju dhënë juve një rol aktiv në procesin zgjedhor, duke i cenuar të drejtat subjektivit zgjedhor Partia Demokratike të Shqipërisë për të përfituar nga dispozitat e Kodit Zgjedhor që brenda 60 ditëve nga data e zgjedhjeve të ketë mundësi të bëjë koalicione zgjedhore. Kjo është mënyra më aktive që ju keni ndërmarrë, duke pasur në konsideratë edhe vendimin e KAS-it, zoti Komisioner, i cili shprehet fare qartë që afati që keni vendosur ju publikisht, se në vendim nuk ishte gjëkund, prej 48 orësh, kishte mbaruar në orën 10 të datës 11. Si i tillë Komisioneri nuk ka marrë asnjë veprim për më shumë se 100 orë për të pasur një vendimmarrje përfundimtare, e cila na jep të drejtën për t'u ankuar në KAS, ndaj veprimet dhe mosveprimet tuaja në kohë i kanë shkaktuar Partisë Demokratike një dëm të jashtëzakonshëm ligjor duke mos i dhënë mundësinë që të jetë pjesë e koalicioneve parazgjedhore. Gjithashtu, pretendimi juaj në lidhje me autorizimin ku vlerësoni që subjekti që jep autorizimin është i identifikuar, personat që marrin tagrat nga autorizimi janë të identifikuar, por nuk është mjaftueshëm i qartë për ju, më bën të mendoj që qëndrimi juaj në këtë pikë nuk është mjaftueshëm korrekt ose më saktë nuk bazohet në asnjë dispozitë të ligjit sesi mund të interpretohet një autorizim. Ka disa autorizime, ka autorizime për veprime të posaçme që identifikohen posaçërisht në autorizim, ka edhe autorizime të përgjithshme për një sërë tagrash, të cilat mundet që autorizuesi t'ia lërë autorizuesit në diskrecionin e tij. Në këtë rast kemi të bëjmë me një autorizim të përgjithshëm, sipas të cilit unë si i përfaqësuar kisha të gjithë tagrat në diskrecionin tim për të marrë veprime në bazë të veprimeve të lejuara në atë autorizim. Por interpretimi juaj që nuk ka datën korrekte të zgjedhjeve, nuk mundet, zoti Komisioner të merret për bazë për sa kohë që ai autorizim ishte i vlefshëm për çfarëdolloj date zgjedhjesh vendore që do të kryheshin në vitin 2023. Mund të kryhen 10 zgjedhje vendore në vitin 2023 për të 10 ai autorizim është i vlefshëm dhe kjo është fare e qartë. Si rrjedhojë arsyetimi juaj në lidhje me këtë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

autorizim është i mangët dhe nuk bazohet në asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor dhe Kodit të Procedurës Civile në rast se po e marrim konkretisht. Gjithashtu, edhe interpretimi në lidhje me nenin 64, është interpretim individual, është edhe interpretim që nuk mund të bëhet pengesë për regjistrimin e partive politike, pavarësisht faktit se ajo është një deklaratë solemne, e cila është në kompetencë të kryetarit të partisë për sa kohë që ai është në funksion si kryetar partie. Por angazhimet që ai merr në këtë deklaratë, janë angazhime në emër të partisë dhe në autorizimin të cilin përmendim, e ka specifikuar fare qartë që kjo kompetencë i delegohet një prej të autorizuarve. Është e specifikuar qartësisht në autorizim. Ndaj si një e drejtë dhe një detyrim që lind si pasojë e funksionit, edhe ai mund të delegohet. Ndaj, zoti Komisioner, ne edhe në shkresën që kemi përcjellë pranë jush e kemi bërë të qartë që zoti Basha rezulton i regjistruar në regjistrin e partive politike, pavarësisht faktit që ka dhënë dorëheqjen. Ekziston i regjistruar në këtë regjistër për faktin e vetëm se në bazë të ligjit për partitë politike nuk mund të depozitohet dorëheqja, depozitohet vetëm akti administrativ i emërimit të kryetarit të ri. Për sa kohë që partia Demokratike nuk ka kaluar në një proces zgjedhor, është e pamundur që të bëhet regjistrimi i zgjedhjes së kryetarit të ri. Ligji është i qartë, në regjistër nuk regjistrohet as zëvendëskryetari, as ndonjë organ tjetër, por regjistrohet vetëm zgjedhja e kryetarit të ri. Kjo është edhe ajo çka kishim për të thënë për kërkesën, pavarësisht se nuk jemi njohur ende me qëndrimin e Komisionerit, të cilin jemi shumë të vullnetshëm për ta dëgjuar menjëherë pas mbarimit të fjalës sonë.

**Z. I. Celibashi:** Keni gjë tjetër para se ta përfundoj shqyrtimin?

**Z. I. Sefa:** Para se ta përfundoni, do të kërkoja shkurtimisht të na bënit një shpjegim të mendimit tuaj në lidhje me kërkesën, pastaj të mbajmë qëndrim mbi mendimin

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

tuaj dhe pastaj jeni të lirë të vendosni. Prandaj shërben edhe ai projektvendimi i famshëm, sepse na jep idenë se çfarë qëndrimi do të mbani dhe të mbajmë edhe ne qëndrim mbi pretendimet tuaja.

**Z. I. Celibashi:** Opinioni im është arsyetimi mbi vendimmarrjen time dhe mbi këtë vendim, pastaj ju keni gjithë të drejtën tuaj ligjore që ta kundërshtoni vendimin tim.


**Z. I. Sefa:** Patjetër. E përcakton Kodi Zgjedhor. Është një e drejtë që na e jep ligji.

**Z. I. Celibashi:** Qëndrimi im në vijim është arsyetimi im mbi vendimin tim bazuar në shqyrtimin e kërkesës suaj për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor. Pyetja që kam përsëri: keni prova, argumente të tjera në mbështetje të kërkesës suaj për të regjistruar Partinë Demokratike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e 14 majit 2023? Nëse nuk keni, e mbyllim këtu dhe unë të vazhdoj me shpalljen e vendimit në lidhje me kërkesën tuaj.

**Z. I. Sefa:** Provat e paraqitura nga Partia Demokratike janë të plota dhe në zbatim të ligjit. Nuk ka asnjë provë tjetër. Ju referova që provat e depozituara nga Partia Demokratike janë ato që i janë bashkëlidhur kërkesës, si dhe dy shkresat e protokolluara pranë KQZ-së, të cilat referojnë në mënyrë të qartë që Partia Demokratike nuk ka ndërmend të sjellë prova nga ato që kërkoni ju si Komisioner, por është në zbatim të ligjit me të gjithë dokumentacionin e paraqitur.

**Z. I. Celibashi:** Pra, me sa kuptova, ju thoni që dokumentacioni është i plotë, kërkesa për t'u regjistruar Partia Demokratike ka gjithë dokumentacionin shoqërues sipas asaj që përcakton Kodi Zgjedhor, ndaj duhet të regjistrohet si subjekt zgjedhor

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

për zgjedhjet e 14 majit. Faleminderit! Nëse nuk kemi diçka tjetër, e përfundojmë shqyrtimin administrativ. Zoti Nuraj.

**Z. L. Nuraj:** Po, i nderuar, si përfaqësues i Partisë Demokratike në këtë seancë në lidhje për vendosjen për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, të mos hamë kohë, se koha është shumë e vyer, do të doja të thosha që në lidhje me kërkesën e paraqitur për Partinë Demokratike, me shkronja nistore Partia Demokratike e Shqipërisë, me kryetar Sali Berishën. Në bazë të kërkesës së ardhur në datën 5.3.2023 sipas gjithë kërkesave të Kodit Zgjedhor si nga ana formale, ashtu edhe nga ana përmbajtësore, do të kërkonim regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e 14 majit të vitit 2023. Në seancën e parë ju u shprehët kur latë 48 orë kohë për plotësim dokumentacioni. Ne bëmë një ankim, pasi në gjykimin tonë nuk ishte e drejtë ajo vendimmarrje, pasi nuk kishte nevojë fare për 48-orëshin apo për plotësimin e dokumentacionit, pasi dokumentacioni i sjellë nga ana jonë ka qenë më se i plotë sipas ligjit dhe Kodit Zgjedhor. KAS-i nuk është se e ka rrëzuar si kërkesë, por nuk e ka pranuar si kërkesë, kërkesën tonë me arsyetimin që ka qenë një vendim i ndërmjetëm i Komisionerit në lidhje me vendimin për pjesëmarrje të Partisë Demokratike në zgjedhje apo jo. Kështu që, i nderuar, në lidhje me atë që ju keni kërkuar, unë mbaj qëndrim sot që ne nuk kemi çfarë dokumentacioni duhet të plotësojmë tjetër, pasi edhe duke iu referuar Kodit Zgjedhor dhe në dokumentacionet që përcakton Kodi Zgjedhor, seti i dokumentacionit të dorëzuar sipas kërkesave ligjore është në përputhje me Kodin Zgjedhor. Nëse do të ishte e nevojshme, unë përsëri i referoj, ne kemi dorëzuar kërkesën e Partisë Demokratike, me firmën e kryetarit të saj, zotit Sali Berisha. Kemi depozituar të gjitha vendimet që kanë marrë dhe që kanë ardhur në zgjedhjen e kryetarit të saj, të gjitha proceset ligjore që janë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

ndjekur. Kemi dorëzuar edhe një vendim të Gjykatës së Shkallës të Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin të gjitha vendimet e ardhura në kuvendin e 11 dhjetorit duhet të pasqyroheshin në regjistrin e partive politike. Dua të theksoj se aktualisht në regjistrin e partisë politike, Partia Demokratike Shqipërisë, që mbahet në Gjykatën e Tiranës ndryshimet janë të pereflektuara që nga viti 2018. Nga 2018-ta deri më sot kemi një sërë ndryshimesh që kanë ndodhur në lidhje me Partinë Demokratike dhe ndryshimet kanë konsistuar në ato pika kryesore, ku janë ndryshuar statutet, janë ndryshuar organet drejtuese të saj, edhe kryetari i Partisë Demokratike. Të gjitha këto ne i kemi argumentuar me dokumentacionet përkatëse në setin tonë. Megjithatë, përveçse referuar nenit 64 të Kodit Zgjedhor, që ne i kemi plotësuar për t'u regjistruar, ne i referohemi dhe dua të sjellim në vëmendjen tuaj, të zbatohet edhe neni 139 i Kodit Zgjedhor, ku thuhet se për fakte të njohura botërisht, dhe për ato fakte që janë të ditura për KQZ-në, për shkak të funksioneve të saj, nuk nevojitet verifikim apo kërkesë gjatë hetimit administrativ të çështjes e të tjera, kështu që Komisioneri mund të marrë vendim të pavarur duke u bazuar dhe në fakte të njohura botërisht. Faktet e njohura botërisht janë që në Partinë Demokratike kanë ndodhur procese ndryshimi të ardhura sipas vullnetit të zgjedhësve të saj. Faktet e njohura botërisht tashmë dihen që prej një viti: Partia Demokratike ka kryetar zotin Sali Berisha, ka organet e saj drejtuese, e zhvillon jetën e saj politike në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që normojnë jetën politike të një vendi. Tashmë faktet janë publike, ku shikohet edhe numri i votave që u morën në zgjedhjet e fundit, elektorati, zgjedhësit. Kështu që, i nderuar, Komisioner, sot ju keni përgjegjësinë të merrni një vendimmarrje në lidhje me Partinë Demokratike të Shqipërisë, në kërkesën që ju ka ardhur dhe setin e dokumentacionit, që ju është paraqitur dhe të bëni regjistrimin e saj si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e 14 majit të vitit 2023. Duke pasur përgjegjësinë që ju nuk mund të përjashtoni një elektorat prej

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

600-mijë votuesish, duke ju mohuar të drejtën e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje apo duke u mohuar një alternativë këtyre votuesve, apo gjithë votuesve në përgjithësi. Kjo është Partia më e madhe opozitare në 32 vjet, është një parti që tashmë ka operuar dhe njihet, nuk është një parti e krijuar rishtaz para 2 apo 3 vitesh dhe vërtet ne do të themi që, ore, si është situata? Mbi bazën e këtyre, mbi bazën e Kodit Zgjedhor, që juve ju lejon, duke parë që edhe rasti nuk është në rastet klasike, por është pak atipik, sepse për artificat që janë krijuar gjithë këto kohë, kur janë po prapë edhe këto të njohura botërisht, nuk janë pasqyruar në regjistrin e partive politike, në regjistrin e Partisë Demokratike, që administrohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkojmë që të bëhet regjistrimi i Partisë Demokratike, me formë administratore Partia Demokratike e Shqipërisë, me kryetar Sali Berishën. Kështu që nuk shikoj asnjë pengesë në vendimmarrjen tuaj, i nderuar. Faleminderit!


**Z. I. Celibashi:** Po, zoti Sefa.

**Z. I. Sefa:** Ju lutem, mund të më përcaktoni pak numrin dhe datën e depozitimit të kërkesës që po shqyrtohet.

**Z. I. Celibashi:** Zoti Sefa, e kemi bërë këtë diskutim dhe nuk e di pse jeni duke i bërë autogol vetes me çfarë po thoni. Sinqerisht po jua them: ne po shqyrtojmë kërkesën e Partisë Demokratike për t'u regjistruar në zgjedhjet vendore.

**Z. I. Sefa:** Zoti Komisionier, autogolin ma lini mua ta bëj në portën time, por unë nga ana juaj dua të di numrin e kërkesës që po shqyrtohet në këtë moment dhe datën e depozitimit, numrin e protokollit që kam marrë në KQZ dhe datën e depozitimit.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Tani, ne jemi duke shqyrtuar kërkesën e Partisë Demokratike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor, kërkesën për t'u regjistruar partia si subjekt zgjedhor e ka bërë pala juaj dhe pala tjetër. Në shqyrtimin e kësaj kërkesë ne vlerësojmë legjitimitetin e palës për ta bërë këtë kërkesë dhe në përfundim vendosim, në përfundim jo me vendim të ndërmjetëm, vendosim regjistrimin ose mosregjistrimin e një partie politike si subjekt zgjedhor.

**Z. I. Sefa:** Të lutem, kam bërë kërkesë të depozituar në datën 6 mars në KQZ me numër protokoll. Çdo individ tjetër, që bën kërkesë tjetër, të shqyrtohet veçantë dhe aty në vendimin tjetër Komisioneri të vlerësojë legjitimitetin ose jo për kërkesën. Me këtë logjikë unë vij në emër të Partisë Socialiste, regjistroj një kërkesë edhe e mbaj Partinë Socialiste në Kolegjin Zgjedhor gjithë jetën, sepse ju nuk më legjitimoni. Edhe një herë më tregoni numrin e kërkesës dhe datën e depozitimit të saj, e cila po shqyrtohet në këtë moment. Janë 2 kërkesa me dy subjekte, të cilat pretendojnë një emër. Secili ka të drejtë të pretendojë çfarë të dojë, por unë ju kërkoj që ju të shqyrtoni kërkesën e depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë.

**Z. I. Celibashi:** Atë po shqyrtoj, zoti Sefa.

**Z. I. Sefa:** Jo, se po shqyrtoni me 2 kërkesues.

**Z. I. Celibashi:** Po shqyrtoj 2 kërkesa të Partisë Demokratike.

**Z. I. Sefa:** Ku e dini ju që është Partia Demokratike?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Jo, nuk e di, por tani do ta marrësh vesh edhe ti se kush është Partia Demokratike.

**Z. I. Sefa:** Merre vendimin veç! Merre në vendim tjetër, me numër tjetër vendimi! Po i jepni palës të drejtë të çojë vendimmarrjen tuaj në Kolegjin Zgjedhor, në gjykatë e të gjitha me radhë. Po i jepni ju të drejtë, po ju paralajmëroj, që po i jepni ju të drejtë! Pala që bën kërkim duhet të dalë më vendim për çdo kërkesë; Komisioneri për çdo kërkesë do të dalë me vendim, se me atë logjike që thoni ju, të gjitha partitë dilnin me një vendim. Çdo parti ka dalë me mendim të veçantë. Po ju them merrni vendim vetëm mbi kërkesën e Partisë Demokratike të Shqipërisë, të depozituar nga unë si person përgjegjës! Çdo kërkesë tjetër të dalë me vendim të veçantë. Çdo kërkim tjetër të dalë me kërkim të veçantë.

**Z. I. Celibashi:** Unë e kuptoj shumë mirë këtë që ju po thoni, e kuptoj fare mirë këtë, por ajo se çfarë kërkon është krejt pa sens ligjor. Ne jemi duke shqyrtuar kërkesën e Partisë Demokratike dhe ju po thoni që kërkesën e Partisë Demokratike të paraqitur nga një i tretë tjetër, ju mos e shqyrtoni, shqyrtojeni veçmas. Ka një person juridik Partia Demokratike. Se dhe kush e ka të drejtën për ta paraqitur këtë kërkesën, unë do ta shqyrtoj, do ta vlerësoj.

**Z. I. Sefa:** Po, pra, po shqyrtoje!

**Z. I. Celibashi:** Si ta shqyrtojmë me vete, do ta shqyrtojmë bashkë legjitimitetin e personit.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Z. I. Sefa:** Jo, pra nuk e shqyrton dot bashkë, në çdo kërkim, në çdo kërkesë t'i do bësh një vendim për çdo kërkesë. Ju si Komisioner, duhet të bëni vendim për çdo kërkim, në rastin që ju perceptoni... Ja t'ju bëj një pyetje unë. Marrim rastin hipotetik, ju e regjistroni, pala tjetër ankohet, merr fuqi vendimi juaj?

**Z. I. Celibashi:** Jo, ti merr këtë rastin...

**Z. I. Sefa:** Jo, do të marr rastin hipotetik.

**Z. I. Celibashi:** Jo, do të të jap përgjigjen e kësaj. Ja pra një rast hipotetik po të jap edhe unë: ti bën kërkesën për të regjistruar Partinë Demokratike, zotëria tjetër bën kërkesën për të regjistruar Partinë Demokratike. Do ta shqyrtoj edhe kërkesën tuaj edhe të atij veçmas, në rregull? Për kërkesën tuaj unë vlerësoj që do të pranohet, do të regjistrohet Partia Demokratike, për kërkesën tjetër do të them nuk regjistrohet Partia Demokratike, se nuk ka dokumentacion.

**Z. I. Sefa:** Nuk regjistrohet, sepse nuk legjitimohet, se nuk përfaqëson partinë.

**Z. I. Celibashi:** Nuk ka rëndësi shkak.

**Z. I. Sefa:** Komisioner, po të bëj pyetje ligjore: do të dalësh më 2 kërkues në vendimmarrje. Pranon vendimmarrjen për të regjistruar Partinë Demokratike të Shqipërisë përfaqësuar nga personi Indrit Sefa si kërkues, pala tjetër ankimon vendimin, hyn në fuqi vendimi, apo jo?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Do të ta jap përgjigjen, por nuk marr përsipër të përgjigjem për kompetenca...

**Z. I. Sefa:** Përsipër duhet ta merrni, në rast se legjitimoni 2 kërkues në një vendim, po e bëni me qëllim për të penguar regjistrimin e Partisë Demokratike. Ju kërkoj edhe një herë në mënyrë procedurale: ndani kërkimet! Unë dua përgjigje për kërkimin e depozituar nga ana ime, në emër të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Dua vendimmarrje për kërkesën e paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë! Çdo kërkues të marrë vendimmarrje.

**Z. I. Celibashi:** Kush është Partia Demokratike e Shqipërisë, kush e përfaqëson?

**Z. I. Sefa:** Dokumentet që janë aty mbas vlerësimit që keni ju ...

**Z. I. Celibashi:** Si duhet ta vendosi këto, si duhet ta vendosi?

**Z. I. Sefa:** Regjistri i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

**Z. I. Celibashi:** Shumë qartë, po si duhet ta bëj këtë, duhet ta bëj nëpërmjet një procesi?

**Z. I. Sefa:** Merr vendim.

**Z. I. Celibashi:** Do të marr vendim kush ka legjitimitetin, do të marr vendim edhe për të parë sesi është..

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Z. I. Sefa:** Duhet ta marrësh me vendim të veçantë, duhet ta marrë me vendim të veçantë.

**Z. I. Celibashi:** Për kë duhet të marr vendim të veçantë, se nuk po kuptoj?

**Z. I. Sefa:** Për çdo kërkesë, të marrësh vendime për çdo kërkesë siç e ke marrë për çdo parti politike. Nuk mundet Komisioneri kushdo që vjen e kërkon këtu të marrë të gjithë kërkesit t'i fusë në një vendim, sepse hap një lojë me ankime administrative në KAS e Kolegjin Zgjedhor, që nuk mbaron kurrë.

**Z. I. Celibashi:** Zoti Sefa, legjitimitetin e atij...

**Z. I. Sefa:** Zoti Komisionier, legjitimitetin vlerësojeni në vendimin..

**Z. I. Celibashi:** Për legjitimitetin e kujt po flisja?

**Z. I. Sefa:** Po kujt do që kërkon në qoftë se kërkoj të regjistroj ...

**Z. I. Celibashi:** Çfarë mendoni se ....

**Z. I. Sefa:** Unë mbaj përgjegjësi për kërkesën e depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, të firmosur nga ana ime si përfaqësues me autorizim. Në moment ju merrni vendimmarrje për këtë kërkim dhe thoni legjitimohet. Dokumentet janë në rregull ose jo, pranohet ose jo kërkesa. Të njëjtën formë do ndjekësh vendimmarrjen për çdo palë tjetër. Fillon me legjitimimin, me vendimmarrje të veçantë, legjitimoje një herë, në qoftë se nuk legjitimohesh, nuk vazhdon shqyrtimin, por duhet të bësh

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

një herë legjitimimin, por në vendimmarrje të veçantë. Unë jam Partia Demokratike e Shqipërisë. Kërkesa tjetër është Partia Demokratike, unë në statut e kam emrin Partia Demokratike e Shqipërisë, pse janë të dyja bashkë këto?

**Z. I. Celibashi:** Unë kam përshtypjen se e bëra një herë këtë sqarim po je ...

**Z. I. Sefa:** Po të bëj një kërkesë ...

**Z. I. Celibashi:** Ja ta sqaroj edhe një herë.

**Z. I. Sefa:** Kërkesa është shumë e drejtë. Të lutem, më shpjegoni çfarë numri dhe date depozitimi ka kërkesa që po merrni në shqyrtim tani? Unë dua këtë përgjigje nga ana juaj.

**Z. I. Celibashi:** Ne po shqyrtojmë kërkesën e Partisë Demokratike dhe çështjen e legjitimitetit për ta bërë këtë kërkesë ne e kemi zgjidhur në seancën e parë. Më shqip se kaq mundet ta them.

**Z. I. Sefa:** Komisioner, në çdo vendim për regjistrimin e partive politike, KQZ-ja fillon: sot në datë 11.03, (po marr këtë seancë publike), mora në shqyrtim kërkesën me numër protokolli 13/12, datë 03.03.2023. Ju lutem, kur dilni me vendim çfarë vendimi, çfarë numri kërkesë dhe date do t'i vendosni vendimit?

**Z. I. Celibashi:** Numrin e vendimit? Numri dhe datën që do të marrë vendimi. Çfarë lidhje ka kjo?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Z. I. Sefa:** Numrin e kërkesës. ...

**Z. I. Celibashi:** Po. Çfarë lexon aty më tej, kush është kërkuar?

**Z. I. Sefa:** Kërkuar është Partia Demokratike e Shqipërisë.

**Z. I. Celibashi:** Ashtu do të jetë edhe në vendim.

**Z. I. Sefa:** Dhe te ky projektvendim keni vënë dy kërkime, dy kërkime me dy data. Unë po them çdo kërkuar të dalë me vendim të veçantë. Po e fusni procesin nën ngërç, po i jep të drejtë palës të ankimojë.

**Z. I. Celibashi:** Jam i sigurt, se kur të dëgjoni vendimin gjithë kjo retorika juaj, do të rezultojë... Retorika ligjore, nuk është retorikë politike, por nuk ka arsye që të bëhet, këtë jam duke thënë.


**Z. I. Sefa:** Nuk ka retorikë, po të kërkoj diçka procedurale dhe shumë të thjeshtë.

**Z. I. Celibashi:** Kush e përfaqëson Partinë Demokratike?

**Z. I. Sefa:** Atë e përfaqësojnë dokumentet që keni aty, zoti Komisionier dhe ju do ta vlerësoni në bazë të dokumenteve që keni aty.

**Z. I. Celibashi:** Këtë po bëjmë, pikërisht këtë po bëjmë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Z. I. Sefa:** Në qoftë se ju mendoni që unë nuk e përfaqësoj, dilni me vendim të veçantë për kërkesën që kam depozituar unë dhe thoni që zotëria nuk legjitimohet, por me vendim të veçantë se, në momentin që vini 2 kërkues këtu, u hapni shteg ankimimeve në të gjithë etapat gjyqësore.

**Z. I. Celibashi:** Tani dy gjëra, e para e punës, çështjen e legjitimitetit të atij që bën ankimimin nuk e zgjidh unë, por e zgjidh organi që do të shqyrtojë ankimimin. E dyta, për qetësinë tuaj dhe për qartësinë tuaj, do të ketë vetëm një kërkues, jam duke ju thënë, Partia Demokratike dhe ai që ka legjitimitetin formal për të paraqitur kërkesën për regjistrimin e Partisë Demokratike. Më qartë se kaq nuk di ta them.

**Z. I. Sefa:** Po të marr shembullin e KAS-it, që në kundërshtim nga ju doli me dy vendime të veçanta.

**Z. I. Celibashi:** Mua nuk më duhet se çfarë vendos një organ tjetër, nuk më duhet fare se çfarë vendos një organ tjetër, në rregull? KAS-i ka shqyrtuar dy ankime, sepse kishte dy ankime..

**Z. I. Sefa:** Siç keni ju dy kërkesa.

**Z. I. Celibashi:** Jo, unë kam një kërkesë.

**Z. I. Sefa:** Jo, ke dy.

**Z. I. Celibashi:** Po tani, ju thoni ke dy, unë kam një kërkesë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Z. I. Sefa:** Dy kërkues.

**Z. I. Celibashi:** Po është kërkesë për çështje tjetër, nuk është kërkesë për regjistrimin e PD-së. Jemi në rregull? Jemi të qartë?

**Z. I. Sefa:** Jo të qartë nuk jemi me thënë të drejtën, por merrni vendimmarrjen, të marrim numrin dhe të bëjmë çfarë kemi për të bërë.


**Z. L. Nuraj:** Më fal, i nderuar, doja të mbaja një qëndrim në lidhje me këtë. I nderuar ka vetëm një Parti Demokratike, është ajo parti demokratike që operon prej 32 vjetësh.

**Z. I. Celibashi:** E bëmë këtë diskutim, zoti Nuraj.

**Z. L. Nuraj:** Kjo seancë duhet vazhdojë për të dyja kërkesat në bashkim të tyre, sepse vendimmarrja për njërin do të paragjykonte në lidhje me vendimmarrjen e kërkesës tjetër. Kështu që në këtë kontekst të vazhdojë të shqyrtohet dokumentacioni i sjellë si nga ne përfaqësues të PD-së, që ka ardhur e përfaqësuar nga kryetar dhe jo me përfaqësues me autorizime, që po t'i shikosh, mund edhe të kenë dokumentacione të falsifikuara dhe do të kërkoja vëmendjen tuaj që t'i shikonit mirë..

**Z. I. Celibashi:** Do të kërkoja mirëkuptimin tuaj që ta përfundojmë këtë sesionin e paraqitjes së argumenteve. E kemi mbyllur këtë diskutim më herët në lidhje me këtë çështje dhe ndaj jam duke e rikonfirmuar për të disatën herë, që jemi duke shqyrtuar kërkesën e Partisë Demokratike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor. Edhe jashtë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

shqyrtimeve procedurale e kemi thënë disa herë që ka vetëm një person juridik me emrin Partia Demokratike dhe në këtë seancë jemi duke shqyrtuar kërkesën e këtij subjekti politik për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e 14 majit 2023. Pra, mendoj që e kemi të qartë. Dakord Zoti Sefa? të vazhdojmë?

**Z. I. Sefa:** Dakord.

**Z. I. Celibashi:** Dakord, u qartësua për këtë çështje. Faleminderit! Atëherë meqenëse që nga momenti që ne kërkuam që t'i vihej në dispozicion një dokumentacion, sipas vlerësimit tonë, i plotësuar nga ana e Partisë Demokratike, me qëllim që të përmbushte të gjitha kushtet për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor dhe meqenëse nuk ka asnjë dokument tjetër, që është ndryshuar ose është shtuar, unë mendoj që jemi në të njëjtën situatë sikurse ishim në seancën e shkuar. Duke qenë se nuk kemi ndonjë kërkesë tjetër shtesë, unë mendoj që të japim gjykimin dhe vlerësimin tonë, pra të Komisionerit, mbi kërkesën për regjistrim të Partisë Demokratike, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e 14 majit 2023. Dua ta them që në krye të herës, që kjo çështje ka pasur meritë për një shqyrtim administrativ edhe në një seancë publike. Vetëm nga aktet dokumentare, që juve vetë si palë i keni paraqitur për të mbështetur kërkesën për regjistrim të Partisë Demokratike, është e qartë për këdo që i ka njohur këto dokumente edhe jashtë kësaj salle, se çështja e përfaqësimit ligjor të kësaj partie, për të paraqitur kërkesën e mësipërme, ka qenë në diskutim. Dhe këtu unë nuk marr fare në konsideratë gjithë konfrontimin tuaj të brendshëm politik për këtë çështje, i njohur edhe ky botërisht, pasi nuk është çështje e interesit dhe e kompetencës së ligjshme të Komisionerit. Por në vlerësimin ligjor, që unë i bëj këtij dokumentacioni, ka disa fakte dhe pretendime, të cilat unë i gjej të mbështetura në ligj dhe disa jo. Qëndron ligjërisht pretendimi i njërës palë, që zoti


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

Lulzim Basha është kryetar i PD-së, sepse kështu rezulton nga vërtetimi i zyrës së regjistrimit të partive politike të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Nuk ka qëndruar ligjërisht pretendimi tjetër, që zoti Sali Berisha është kryetar i Partisë Demokratike. Ndaj mbi faktin e pakontestueshëm ligjor se zoti Lulzim Basha është kryetar i PD-së, pala e cila e ka paraqitur këtë fakt dhe ka paraqitur kërkesën për t’u regjistruar kjo parti, si subjekt zgjedhore në zgjedhjet e 14 majit 2023, ka legjitimitetin e plotë. Pra, në vlerësimin tim, në pikëpamje formale, zoti Lulzim Basha ose personat e autorizuar nga ky i fundit, në cilësinë e tij si kryetar, kanë të gjithë legjitimitetin për të paraqitur kërkesën në emër të PD-së për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor. Por, në vlerësimin tim, duhet që ky autorizim, sikurse kam vlerësuar edhe më herët, duhet të jetë plotësisht i qartë dhe i plotë, në lidhje veçanërisht me tagrat e të autorizuarit. Përveç paqartësisë të autorizimit, në vlerësimin tim, dokumentacioni për regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, si subjekt zgjedhor, i paraqitur nga ju, si i autorizuar nga zoti Basha, ka një mangësi themelore. Deklarata solemne duhet të jetë e nënshkruar nga vetë kryetari i Partisë Demokratike, zoti Lulzim Basha. Por, në fakt, rezulton se ajo është e nënshkruar nga zoti Enkelejd Alibeaj, nënkryetar i Partisë Demokratike, i cili është i autorizuar, sipas dokumentacionit nga zoti Basha. Në bindjen time, e bazuar kjo bindje në ligj, deklarata është një akt që duhet të nënshkruhet vetëm nga kryetari i partisë. Se përse ligjvënësi i ka dhënë kaq rëndësi këtij dokumenti, kjo nuk është një çështje e Komisionerit. Në vlerësimin tim, përmbajta e nenit 64, pika 2, shkronja “e”, e Kodit Zgjedhor, nuk lë vend për interpretim tjetër. Në pamje të parë deklarata duket si një element formal dhe jo lidhur ngushtësisht me vlefshmërinë e procesit të regjistrimit të një partie politike si një subjekt zgjedhor, por në fakt, në kuptim të përmbajtjes dhe interpretim të drejtë të normës ligjore nuk është kështu. Formulimi i mësipërm i kësaj dispozite nuk lë vend për kuptime ose interpretime të tjera veç atij se paraqitja e këtij dokumenti


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

është kusht për pranimin e kërkesës për regjistrim të një partie politike si subjekt zgjedhor. Për të kuptuar rëndësinë dhe vlefshmërinë juridike të një procesi, bazuar edhe në një aspekt formal të tij, ju sjell si shembull zgjedhjen e Presidentit të Republikës, por ka edhe shembuj të tjerë. Presidenti i Republikës, sikurse ju e dini, zgjidhet nga Kuvendi. Vendimi i Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës nuk i jep atij automatikisht të drejtën për të ushtruar funksionin pa bërë betimin. Betimi është vërtetë një akt formal, është një akt solemn, ashtu sikurse edhe deklarata, por moskryerja e këtij, sikurse përcaktohet në Kushtetutë, nuk e lejon Presidentin të fillojë ushtrimin e detyrës. Për të njëjtën vlerë juridike në lidhje me pranimin e kërkesës për regjistrimin e partisë politike, si subjekt zgjedhor, mbart edhe deklarata solemne, referuar nenit 64 pika 2, shkronja “e” të Kodit Zgjedhor. Nënshkrimi nga nënkryetari Alibeaj është bërë në bazë të autorizimit që zoti Lulzim Basha, si kryetar i Partisë Demokratike, ka lëshuar në datën 18 mars të vitit 2022. Përfaqësuesi i Partisë Demokratike, ju zoti Sefa, keni pretenduar se zoti Alibeaj e ka të drejtën të nënshkruajë edhe deklaratën solemne të angazhimit, pasi është i autorizuar nga kryetari i partisë për ta bërë këtë. Unë vlerësoj që ky pretendim i juaji nuk ka bazë ligjore. Deklarata solemne e kryetarit të partisë, sipas asaj që përcakton neni 64, pika 2 të Kodit Zgjedhor, duhet të nënshkruhet vetëm nga kryetari i partisë. Përmbajtja e nenit 64 është shumë e qartë në lidhje me përgjegjësinë që kryetari i partisë ka për të marrë angazhimin solemn në emër të partisë për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës e të tjera. Ky angazhim është një përgjegjësi personale e kryetarit të partisë, dhe si e tillë, ajo nuk mund të jetë e transferueshme tek të tjerët. Karakteristika 1, e solemnitetit të deklaratës, si edhe përcaktimi se deklarata duhet të jetë e nënshkruar nga kryetari i partisë, tregon qartë se ai dokument është një akt ekskluziv vetëm i kryetarit të partisë. Si solemniteti, të cilin ky dokument e ka si karakteristikë, ashtu edhe urdhërimi për të nënshkruar me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

titull të përcaktuar, nuk mundet të delegohen, përveçse ligji e parashikon ndryshe. Në rastin konkret, nuk ka një përcaktim ndryshe as në Kodin Zgjedhor, as në ligjin për partitë politike dhe në asnjë pjesë tjetër të legjislacionit. Përgjegjësia vetëm e kryetarit të partisë për të bërë këtë deklaratë për analogji është e njëjtë me përgjegjësinë e një dëshmitari. Në seancën e kaluar ju dhashë një shembull tjetër, sot po ju jap një shembull tjetër. Përgjegjësia e një dëshmitari në një proces gjyqësor apo edhe në një proces administrativ nuk mundet të transferohet tek të tretët. Ajo është gjithmonë dhe tërësisht një përgjegjësi personale. Nëse deklarata angazhuese e kryetarit të partisë do të lejohet të paraqitet edhe nga një person tjetër, i autorizuar prej kryetarit, atëherë ligjvënësi nuk do të ishte kujdesur që ta përkufizonte atë si solemne. Gjithashtu, ligjvënësi nuk do të ishte kujdesur të tregonte qartë se ajo, pra deklarata, duhet të jetë e nënshkruar nga vetë kryetari i partisë. Kjo do të thotë se përndryshe, formulimi i dispozitës në fjalë, do të mjaftohej vetëm me një përmbajtje të tillë për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje një parti politike duhet të paraqesë në KQZ: “deklaratën nga kryetari i partisë ku përmendet...” e të tjera e të tjera. Pra, do ta kishte evituar përcaktimin solemn dhe përcaktimin që deklarata do të duhej të nënshkruhej nga kryetari i partisë dhe do të mjaftonte të kisha atë formulim, që thashë së fundi. Nëse formulimi do të ishte si më sipër, atëherë mund të kishte vend për interpretim në kuptimin, që deklarata si akt, mund të nënshkruhej nga një person tjetër i autorizuar sikurse ndodh me dokumentet e tjera të kërkesës për regjistrim të një partie politike si subjekt zgjedhor. Nga ju u pretendua se është fakt i njohur botërisht që: që prej marsit të vitit 2022 zoti Lulzim Basha ka dhënë dorëheqjen si kryetar i Partisë Demokratike. Në këto kushte, nuk është e mundur që zoti Basha të nënshkruajë deklaratën solemne. Në vlerësimin tim ky pretendim nuk ka asnjë bazë ligjore. Për më tepër, ky pretendim vjen në kontradiktë me veprimet konkrete të bëra nga ana juaj, si i autorizuar prej zotit Lulzim Basha,


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

kryetar i Partisë Demokratike. Kur është rasti për të legjitimuar kërkesën tuaj për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor nga ana juaj, kundrejt pretendimit të zotit Sali Berisha se ky i fundit ka legjitimitetin për të kërkuar regjistrimin e PD-së si subjekt zgjedhor, ju sillni si provë faktin e pakundërshtuar juridik, të pasqyruar në vërtetimin e zyrës së regjistrimit të partive politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, sipas të cilit, kryetar i Partisë Demokratike është zoti Lulzim Basha. Kur ju kërkohet që, përderisa zoti Lulzim Basha, është kryetar i Partisë Demokratike dhe është vetëm ai, që sipas ligjit, duhet të përmbushë detyrimet që Kodi Zgjedhor i ngarkon atij posaçërisht në procesin e regjistrimit të partisë politike si subjekt zgjedhor, atëherë ju sillini në vëmendjen e Komisionerit pretendimin se zoti Lulzim Basha, tashmë ka dhënë dorëheqjen, si kryetar dhe se ky është një fakt i njohur botërisht. Për këtë shkak, sipas jush, nuk është e mundur që atij t'i merret nënshkrimi për deklaratën solemne. Sipas jush, sikurse e thashë edhe më sipër, nënshkrimi i kësaj deklarate nga ai, i autorizuari prej zotit Lulzim Basha, pra, prej zotit Enkelejd Alibeaj, si nënkryetar i Partisë Demokratike, është plotësisht në përputhje me ligjin. Mundet që deklarata të nënshkruhet edhe nga nënkryetari i partisë, por kjo mund të ndodhë vetëm në kushtet kur kryetari i partisë nuk është në detyrë, ai ka dhënë dorëheqjen, apo ka humbur qoftë dhe politikisht interesin për të qenë në atë detyrë, apo ka ndërruar jetë, apo dhe për arsye të tjera. Por në këtë rast duhet që organet e tjera të partisë të depozitojnë në gjykatë njoftimet dhe kërkesat përkatëse sipas të cilave kërkohet që funksionet e kryetarit t'i marrë personi ose organi që sipas statutit të partisë e ka këtë të drejtë. Vendimi ose vendimet e mundshme të organeve përkatëse të partisë, sipas të cilave kompetencat e kryetarit i kanë kaluar personit ose organit përkatës të partisë, duhet të depozitohen në regjistrin e partive politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës. Kështu edhe në rastin konkret kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka dhënë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

dorëheqjen që prej marsit të vitit 2022. Në fakt, për vetë kryetarin e Partisë Demokratike, pra për vetë zotin Lulzim Basha nuk ka asnjë detyrim ligjor për ta formalizuar aktin e dorëheqjes, e për më tepër, për ta paraqitur atë përpara ndonjë institucioni publik. Ai është tërësisht i përligjur në mosinteresin e tij në lidhje me administrimin e dorëheqjes së tij. Por, organet e tjera drejtuese të partisë, si: nënkryetari apo sekretari i përgjithshëm apo kushdo tjetër, që sipas statutit mendohet se mund të marrë funksionet e kryetarit kur ai ka dhënë dorëheqjen, apo edhe një palë tjetër e interesuar, ndoshta në vlerësimin tim, edhe anëtari i partisë do të duhej të depozitonin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës njoftimin sipas të cilit kryetari i Partisë Demokratike apo ish-kryetari, sikurse ju e konsideroni për faktin që botërisht ai ka dhënë dorëheqjen, do të duhet ta kishit depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës. Si ligji për partitë politike, ashtu edhe Kodi Zgjedhor, apo edhe ndonjë ligj tjetër nuk e detyrojnë një parti politike, që në kushtet kur kryetari ka dhënë dorëheqjen, të zgjedhë detyrimisht kryetarin e ri. Për arsye dhe për interesa të veta një parti politike mund të vendosë që ajo për një kohë të caktuar, në vlerësimin e saj dhe sipas parashikimeve të statutit, të drejtohet edhe nga një organ tjetër që e zëvendëson kryetarin. Në këtë rast ky organ i ka të gjitha atributet e kryetarit dhe njihet si i tillë edhe nga të tretë. Organet e tjera drejtuese të Partisë Demokratike, pasi zoti Basha dha dorëheqjen, sipas jush, kanë pasur rreth një vit kohë në dispozicion për të bërë depozitimet e akteve si më sipër përmendur në regjistrin e partive politike në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës. Vetëm kështu në vlerësimin tim nënkryetari i Partisë Demokratike, zoti Alibeaj ose dhe kushdo tjetër organ, që sipas statutit konsiderohet drejtues në Partinë Demokratike, i kishte të gjitha kompetencat e kryetarit të Partisë Demokratike edhe pa qenë kryetar i Partisë Demokratike. Në kushtet kur në zyrën e regjistrit të partive politike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës nuk është bërë njoftimi i dorëheqjes së zotit

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

Lulzim Basha, si kryetar, si dhe nuk është bërë depozitimi i aktit, sipas të cilit, bazuar në statutin e Partisë Demokratike është zoti Alibeaj, ai që ushtron detyrën e kryetarit atëherë, ai si nënkryetar i Partisë Demokratike, mund të pranohet se i ushtron disa kompetenca të kryetarit apo edhe pjesën më të madhe të tyre, por nuk mund të pranohet kurrsesi që ai ushtron të gjitha kompetencat edhe përgjegjësitë e kryetarit të Partisë Demokratike. Ndaj në kushtet kur deklarata nuk është sipas përcaktimeve të nenin 64, pika 2, shkronja “e”, në vlerësimin tim dhe sipas vlerësimit tim do të duhej të nënshkruhej nga kryetari i partisë ose nga ai person, i cili ligjërisht i ushtron atributet e kryetarit të partisë, unë mendoj dhe vlerësoj se kërkesa e Partisë Demokratike për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor nuk ka bazë ligjore dhe nuk duhet të pranohet. Në përfundim më lejoni që, veç çfarë thashë më sipër, ku është e qartë që Partia Demokratike nuk mund të regjistrohet si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e 14 majit të vitit 2023, kam të gjithë të drejtën të them sa vijon: Kjo vendimmarrje është tërësisht në vlerësim ligjor të fakteve dhe në interpretim të bazuar, në bindjen time të brendshme, të ligjit zgjedhor mbi procedurat për regjistrimin e një partie politike si subjekt zgjedhor. Nuk ka absolutisht asnjë interes politik, apo tjetër, veç atij të respektimit nga kushdo, qoftë kjo edhe partia më e madhe e opozitës, për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ligji zgjedhor. Ndaj do t’ju lutesha të tregoni të gjithë respektin që meriton pozicioni i Komisionerit!

**Z. I. Sefa:** Patjetër.

**Z. I. Celibashi:** Ju lutem, të mbaroj! Edhe ta qasni këtë çështje, ashtu siç duhet të qaset, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Kjo ju bën nder ju, se, përse duhet bërë kështu, se përndryshe për mua, nuk ka absolutisht asnjë lloj problemi çfarëdo që ju apo kushdo tjetër komenton në lidhje me këtë vendimmarrje.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Z. I. Sefa:** Patjetër! Sa kohë që vendimmarrjet tuaja, zoti...

**Z. I. Celibashi:** Nuk kam mbaruar ende, ju lutem!

**Z. I. Sefa:** Më falni!

**Z. I. Celibashi:** Ajo, çfarë është e drejtë, duhet bërë si e drejtë edhe pse askush nuk e bën dhe ajo, çfarë është e gabuar, nuk duhet bërë edhe sikur të gjithë ta bëjnë. Ky është një parim që unë e njoh prej kohësh. Ndaj, në çfarëdo mënyre tjetër, jo të përshtatshme, që ju do ta qasni këtë kundërshtim, veçse konfirmon edhe një herë atë, që në 30 vjet, çfarë partitë politike bëjnë dhe sillen kundrejt institucioneve publike nuk është ajo që duhet. Për ta përfunduar, sepse kjo pjesa e fundit nuk ka lidhje me arsyetimin ligjor.

Atëherë, vendos:

- Mospranimin e kërkesës së Partisë Demokratike të Shqipërisë, me kryetar zotin Lulzim Basha, për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e datës 14 maj të vitit 2023.

- Kundër këtij vendimi keni të drejtën e ankimit në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

Faleminderit!

**Z. I. Sefa:** A mund të mbaj një qëndrim të shkurtër, zoti kryetar?

**Z. I. Celibashi:** Zoti Sefa, kjo çështje u mbyll, ju jeni të lirë t'i mbani qëndrimet tuaja jashtë kësaj seance.

**Z. I. Sefa:** Doja të lexoja...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Kjo çështje është e mbyllur, ju lutem!


**Z. I. Sefa:** E di që është e mbyllur, patjetër.

**Z. I. Celibashi:** Ju lutem, ta respektojmë, të paktën, formalisht njëri-tjetrin! Ju keni të gjithë të drejtën dhe komoditetin, që edhe këtu në këtë sallë të bëni të gjitha deklaratimet që dëshironi, por në këtë seancë...

**Z. I. Sefa:** Zoti Komisioner, prandaj, qëndrimi im ishte që në bazë të ligjit ju do të merrnit projektvendim, por... E kemi të qartë se çfarë do të bëni. Mirupafshim!

**Vendimi nr. 172**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

Data 14.03.2023

Ora 17:12

**RENDI I DITËS**

**“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”,  
për regjistrimin si objekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të  
datës 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Z. Y. Merkaaj, Znj:M. Koja, P. Doçaj**
- **Parti Politike:**      **PDSH, Bindja Demokratike, Partia  
e Lirisë, Lëvizja Bashkë, LZHK**
- **OJQ:**      **KRIIK, Përfaqësues nga Shoqëria  
Civile**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së partisë “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e 14 majit 2023. Po, përfaqësuesi i Partisë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, zoti Fabian Topollaj, ka fjalën.

**Z. F. Topallaj:** Përshëndetje, i nderuar! Në mënyrë përmbledhtas që të mos zgjatemi, Lëvizja për Zhvillim Kombëtar ka depozituar në gjykatë kërkesën për ndryshimin e emrit të saj, për këtë arsye, vetëm në formularin e kërkesës së plotësuar, sipas rregullave, ne pretendojmë që emri i partisë politike zyrtar, sipas nesh, për shkak të

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

statuti është: “Aleanca Progresiste LZHK”, të gjithë dokumentacionin tjetër në e kemi plotësuar në përputhje me regjistrin, kështu që kërkojmë që partia të regjistrohet me emrin “Aleanca Progresiste LZHK”, në zgjedhjet e 14 majit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, vlerësoj që: kërkesa për regjistrimin, si subjekt zgjedhor i partisë “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” pranohet, por emri i partisë dhe të dhënat e tjera do të jenë ato sipas regjistrit të partive politike të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Pra, partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” do të ketë të njëjtin emër sikurse po e citoj, sepse ashtu është edhe në dokumentacionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës. Faleminderit!

**Vendimi nr. 173**

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

Data 14.03.2023

Ora 17:14

**RENDI I DITËS**

**“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Komitetit Nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z.Arlind Qori, si kandidat për Kryetar Bashkie në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ:      **Z. Y. Merkaaj, Znj:M. Koja, P. Doçaj**
- **Parti Politike:**      **PD, LZHK, PDIU**
- **Të tjerë:**      **KRIIK, Përfaqësues i kandidatit**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së Komitetit Nismëtar, i cili do të organizojë punën për paraqitjen e kandidatit, të mbështetur nga zgjedhësit, zotin Arlind Qori. Ju jeni përfaqësuesi?

**Përfaqësuesi i kandidatit:** Po.

**Z. I. Celibashi:** A keni gjë për të thënë?

**Përfaqësuesi i kandidatit:** Jo.

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Dakord. A kemi ndonjë pretendim? Nuk kemi ndonjë pretendim. Miratohet kërkesa për regjistrimin e Komitetit Nismëtar, i cili do të organizojë punën për paraqitjen e kandidatit të mbështetur nga zgjedhësit, zotit Arlind Qori, për Bashkinë e Tiranës, për zgjedhjet e 14 majit të vitit 2023. Faleminderit! Seanca mbyllet.

**Vendimi nr.174**

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*

